



FOL



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KÔBOVA KËSHILLI PROKURORIAL TË KOSOVËS - TUZHLAKI SAVET KOSOVA SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT	
ARKIVA - ARHIVA	
25 -11- 2020	
Nr./Br: A197 / 2020 MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT	
PRISHTINË - PRIŠTINA	

ndërmjet

KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS (KPK)

dhe

LËVIZJES "FOL",

INTERNEWS KOSOVA

dhe

DEBATE CENTER

Nëntor 2020

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), bazuar në Ligjin 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjin Nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjin Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Organizatat e Shoqërisë Civile: FOL, Internews Kosova dhe Debate Center nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi:

Neni 1 [Fushëveprimi]

Ky Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet KPK-së në njérën anë, dhe Fol, Internews Kosova dhe Debate Center në anën tjetër lidhet me qëllim të zbatimit të projektit "Accountable, Credible and Transparent Justice Sector in Kosova- ACT-JS" (Shqip- Sistemi i Drejtësisë në Kosovë i Përgjegjshëm, i Besueshëm dhe Transparent"). Ky projekt është financuar nga INL (Byroja e Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit) dhe do të zbatohet nga Fol, Internews Kosova dhe Debate Center.

Neni 2 [Qëllimi i Memorandumit]

Qëllimi i këtij memorandumi është të përcaktojë veprimet e përbashkëta ndërmjet KPK-së dhe FOL, Internews Kosova dhe Debate Center për zbatimin e projektit i cili ka për qëllim xritjen e transparencës dhe llogaridhënieve në Sistemin Drejtësisë në Kosovë.

Neni 3 [Përgjegjësitë e KPK-së]

Me qëllim të realizimit të aktiviteteve nga projekti, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Prokurori i Shtetit do u lejojnë qasje monitoruesve në objektet e prokurorisë dhe KPK-së me qëllim të realizimit të vizitave dhe aktiviteteve me studentët.

Monitoruesve do të u mundësohet përcjellja dhe monitorimi i të gjitha mbledhjeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Monitoruesve do të ju mundësohet të kenë qasje në të dhënat statistikore në lidhje me punën e KPK-së, në planet e punës dhe në vendimet tjera të lejueshme.

KPK merr përsipër që të ju ofrojë qasje në dokumente publike të gjithë monitoruesve, në përputhshmëri me Ligjin 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, përfshirë dokumentet dhe informatat lidhur me punën e KPK-së.

KPK do të lejojë që FOL, Internews Kosova dhe Debate Center të bëjnë vizita të rregullta në Prokuroritë Themelore për qëllim të monitorimit të infrastrukturës dhe kushteve të punës.

KPK do të lejojë përfshirjen dhe pasurimin e Komentarit të Kodit të Etikës për Prokurorin e Shtetit me raste të reja që monitoruesit (studentët) do të nxjerrin gjatë monitorimit.

Pasurimi i komentarit me raste të reja do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Gjatë realizimit të këtij projekti në bashkëpunim me prokurorët, mund të filmohen reportazhe të rubrikës "Prokuroria" filimi dhe transmetimi i të cilave do kryhet vetëm pas miratimit nga Kryeprokurori i asaj prokurorie.

KPK nuk merr përsipër asnjë detyrim finansiar, apo çfarëdo lloji tjeter të shpenzimit në raport me monitoruesit.

Neni 4 [Përgjegjësitë e FOL, Internews Kosova dhe Debate Center]

FOL, Internews Kosova dhe Debate Center garantojnë menaxhimin në tërësi të projektit "Sistemi i Drejtësisë në Kosovë i Përgjegjshëm, i Besueshëm dhe Transparent".

FOL, Internews Kosova dhe Debate Center do të garantojnë që çdo monitorues do të nënshkruajë, si kusht për punësim, një deklaratë konfidencialiteti që çdo informacion i marrë sipas procedurave të monitorimit të rasteve prokuroriale do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi që përcakton qasjen në dokumente publike apo në informacione të ndjeshme të karakterit prokurorial.

Të dhënat e grumbulluara nga monitorimi do të përdoren për informimin e publikut për të analizuar rrjedhën e procedurave duke mos identifikuar të dhënat personale të personave të përfshirë në proceset gjyqësore.

Raportet dhe publikimet që burojnë nga monitorimi për qëllime të këtij projekti do të reflektojnë në tërësi parimin e konfidencialitetit, pavarësisë dhe paanësisë së proceseve si dhe qasjen profesionale, analitike dhe etike.

Palët nënshkruese zotohen në respektimin e plotë dhe rigoroz të të drejtave dhe obligimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje dhe njëkohësisht angazhohen dhe vënë në dispozicion kapacitetet e tyre njerëzore dhe infrastrukturore për qëllim të realizimit të marrëveshjes.

Neni 5 [Parimet që qeverisin këtë Memorandum]

Palët pajtohen që në zbatimin e këtij Memorandumit të ndjekin parimet e transparencës së plotë, integritetit dhe angazhimit në mirëbesim ndërmjet tyre.

Palët dakordohen që me qëllim të koordinimit sa më të mirë të aktiviteteve nga kjo marrëveshje të caktojnë nga një person kontaktues të cilët do të lehtësojnë implementimin e marrëveshjes.

Neni 7 [Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve]

Në rast të mosmarrëveshjeve të mundshme në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi, palët dakordohen që të angazhohen në negociata me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 8 [Kohëzgjatja]

Ky Memorandum vë bazat e bashkëpunimit në mes të KPK-së dhe FOL, Internews Kosova dhe Debate Center deri në përfundim të Projektit, me datë, 31 dhjetor 2021, me mundësi vazhdimi.

Neni 9 [Ndryshimi i Memorandumit]

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të plotësohet apo ndryshohet me marrëveshje me shkrim nga të dy palët.

Neni 10 [Nënshkrimi i Memorandumit]

Ky Memorandum është përpiluar në dy kopje identike, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 11 [Hyrja në fuqi]

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët nënshkruese.

PALËT NËNSHKRUENSE

Për KPK-në:



Për Lëvizjen "FOL":



Për Internews Kosova:



Për Debate Center:



Data dhe Vendi: 25.11.2020